

Tiranë, më 13.06.2023

Drejtuar: Kuvendit të Shqipërisë

Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

- Znj. Lindita Nikolla
 - Kryetare e Kuvendit
- Klotilda Bushka
 - (Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, PS)
- Arben Pëllumbi
 - (Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, PS)

Peticion Lidhur me Draft Ligjin “Për Urdhërin e Inxhinierit Hidroteknik Në Republikën e Shqipërisë” të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë me dt 01.04.2022.

<http://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/2c1e3a1a-c0ff-49dc-b1d2-3dc4b0becda4>

Të Nderuar!

Nisur nga publikimi i Draft Projekt Ligjit “Për Urdhërin e Inxhinierit Hidroteknik Në Republikën e Shqipërisë” të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, na lejoni të shprehim komentet tona si grup interesi dhe të përfshirë në këtë sektor me aktivitetin tonë profesional.

Ne jemi grupimi më i madh i inxhinierëve profesionistë të përfaqësuar nga Shoqata Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë që ushtrojmë profesionin e inxhinierit secili në fushat përkatëse sipas eksperiencave profesionale në sektorë të ndryshëm të inxhinierisë

Të dhënat e këtij grupimi i gjeni në materialin e firmosur nga secili inxhinier bashkangjitur këtij dokumenti listë e cila do të përditësohet në vazhdim për shkak të angazhimit profesional dhe shpërndarjes së gjërë të aktivitetit të secilit prej nesh. Ky

Peticion është firmosur me firmë të njomë nga 400 inxhinierët sipas listës bashkangjitur, por edhe në versionin online në faqen change.org prej 2939 profesionistësh inxhinierë rezultatet e të cilit i gjeni po ashtu bashkangjitur këtij material.

<https://www.change.org/p/ne-kundershtim-te-projekt-ligjit-per-urdherin-profesional-te-inxhinierit?redirect=false>

Fillimisht kërkohet të vëmë në dijeni (për të painformuarit) se aktualisht aktiviteti i profesionistëve tanë në vend po funksionon:

- *Bazuar në Ligjin Nr 10 171 datë 22.10.2009, Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë,*
- *LIGJ Nr. 8402, datë 10.9.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (Ndryshuar me ligjet: nr. 9200, datë 26.2.2004; nr.9794, datë 23.7.2007; nr.9826, datë 11.11.2007; nr.10324, datë 23.9.2010; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 8.6.2011; nr.11/2012, datë 9.2.2012; nr.20/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.1.2020)*
- *Ligji nr. 120, dt. 7.10.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar*
- *Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 , "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim",*
- *Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave është miratuar Rregullorja e cila përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:*

1. Organizimin dhe funksionimin e strukturave, që kryejnë dhe mbështesin procesin e licencimit profesional të subjekteve, në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.

2. Kategoritë e punimeve të studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit, kushtet dhe kriteret paraprake, dokumentare dhe specifike, që duhen plotësuar për t'u pajisur me licencë profesionale.

3. Të drejtat që kanë subjektet për t'u pajisur me licencë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit.

4. Detyrimet dhe kufizimet që kanë subjektet, si dhe masat administrative, për rastet e veprimeve në kundërshtim me dispozitat në fuqi, gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Kështu, ky projekt ligji në thelb është antikushtetues, pasi bie ndesh me parimet themelore të ligjshmërisë parashikuar nga Neni 4 i Kushtetutes, ku shprehimisht thuhet:

E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Gjithashtu, sa sipër është në shkelje të ndalimeve të vendosura nga Neni 4/1 i Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS, ku shprehimisht thuhet:

Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.

Në këtë kuader pas leximit me kujdes dhe me përgjegjësi të Projekt Ligjit të publikuar ju lutem na lejoni të shprehim pikat për diskutim të cilat duhet të konsiderohen deri në detaje në mënyrë që të mos aprovohet në Kuvend ky Projekt Ligj.

1. Së pari shprehim pakënaqësinë tonë për ndërmarrjen e një iniciative të tillë nga ana e një individi qoftë ai edhe Deputet duke qenë se kjo është një temë shumë e rëndësishme dhe mendojmë që duhet të jetë tërësisht e pavarur nga Institucionet Shtetërore dhe aq më pak e pavarur politikisht. Kuvendi i Shqipërisë në vecanti duhet të prezantojnë vullnetin e të gjithë komunitetit dhe jo të mbështesin iniciativa spontane të një grupi të caktuar për interesa që nuk përfaqësojnë të gjithë komunitetin përkatës. E themi këtë pasi nuk kemi asnjë material në dispozicion që të vërtetojë që ky draft Projekt Ligj të jetë konsultuar me grupet e interesit dhe të ketë marrë në konsideratë komentet apo sugjerimet e këtij komuniteti.

2. Kështu, Projekt-Ligji i propozuar së pari është një iniciativë e cila ka të prezantuar vetëm emrin e Deputetëve Ismet Beqiraj dhe Andrea Mato në cilësinë e një grupi deputetësh, pra asnjë grup interesi nuk është përfshirë zyrtarisht në procesin e përgatitjes së këtij Draft Projekt Ligji. Në këtë kuadër ne kërkojmë që si grupimi më i madh i profesionistëve Inxhinierë (rreth 3000 inxhinierë) i përfaqësuar nga Shoqata Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë me listën emërore bashkangjitur me autorizimin e përfaqësisë së tyre nga Ing Deshira Mena, të konsiderohemi dhe të marrim pjesë në procesin e diskutimit me grupet e interesit si të barabartë me të gjithë anetarët e përfshirë në këtë proces për të prezantuar qëndrimin tonë tekniko-profesional lidhur me Projektligjin për Urdhërin E Inxhinierit Hidroteknik në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu Hartuesit e këtij materiali “Projekt Ligj - Për Urdhërin E Inxhinierit Hidroteknik në Republikën e Shqipërisë”, duhet të deklarohen se cilët janë, në mënyrë që ne të vlerësojmë nivelin etiko-profesional, experiencën profesionale, shkallën/gradën e kualifikimit shkencor ose kualifikim tjetër, integritetin e profilit profesional, me qëllim leximin dhe gjykimin me të drejtë mbi qëllimin në tërësinë e përmbajtjes së materialit që autorët e këtij ligji kanë konceptuar dhe/ose për ndërtimin ndërmjet nesh “të një bashkebisedimi shpjegues, argumentues, apo oponent me gjuhë profesionale me to”. Në këtë mënyrë, kushdo qofshin vendim-marrësit për aprovimin ose jo të këtij ligji (profesionist ose jo në fushën inxhinjerike), të kuptojnë më mirë se përse ne inxhinjerët që po paraqesim këtë peticion, e kundërshtojmë me forcë këtë projekt ligj.

3. Publikimi i këtij Projekt Ligji në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë nuk shoqërohet Dhënie Mendimi nga Ministritë që do të thotë nuk ka marrë asnjë konfirmim as nga Ministria e Enërgjisë dhe Infratrakturës, dhe as nga Ministritë e tjera përgjegjëse për këto kontribute dhe jo më nga grupet e interesit pasi nuk është diskutuar me to në asnjë moment. Sic është paraqitur ai është një iniciativë individuale e Deputetëve Ismet Beqiraj dhe Andrea Mato (Nuk thuhet sa është numri i individëve profesionistë dhe a përfaqësojnë ato të gjithë inxhinjerët profesionistë në vendin tonë pasi një numër i konsiderueshëm i tyre sipas listës emërore bashkangjitur, është shprehur kundër këtyre Projekt Ligjeve) gjë e cila e vlerësuar në ndikimin e gjërë të shtrirjes që ka ky ligj mbi jetën e profesionistëve në Republikën e Shqipërisë nuk justifikon të merret në konsideratë pa kaluar në

një diskutim të gjërë me publikun e interesuar, me profesionistët e vërtetë. Pra duhet zbardhur me një votim gjithpërfshirës nëse realisht shumica e profesionistëve janë dakort apo jo, dhe nuk mund të spekulohet dhe luhet me jetën e tyre në mënyrë të fshehtë nën petkun e “Ligjit që miratohet në Kuvend”. Nuk është Kuvendi që vulos fatin dhe jetën e Profesionistëve të këtij por janë vetë profesionistët që do të dakortësohen për t’u përfshirë ose jo në një Urdher të tillë dhe për më tepër janë po ato që do të aprovojnë të gjithë përmbajtjen e këtij Projekt Ligji. Vetëm me votim të hapur dhe publik mund të justifikohen iniciativa të tilla kaq thelbësore për jetën e profesionistëve në Republikën e Shqipërisë, në të kundërt ky nuk është Parlamenti i Popullit por i punëve të pandershme të deputetëve tanë, dhe nuk përfaqëson realisht vullnetin e popullit tonë.

Më poshtë komentet tona lidhur me pika të vecanta të këtij Projekt Ligji.

Që në fillim tek Neni 1 dhe Neni 2 i këtij Draft Projekt Ligji ku thuhet :

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe forcimin e autoritetit publik të profesionit të inxhinierit hidroteknik, përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e këtij profesioni, edukimin profesional të inxhinierit hidroteknik, garantimin e standardeve etiko-profesionale në ushtrimin e këtij profesioni,....etj kemi një kontradiktë të hapur me ligjet aktuale si më poshtë:

- *LIGJ Nr. 8402, datë 10.9.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*
- *Ligji nr. 120, dt. 7.10.2020*
- *Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 ,*
- *Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016*

Të cilët përcaktojnë qartë kriteret e ushtrimit të profesionit të Inxhinierit të cdo kategorie në Republikën e Shqipërisë.

Në Nenin 3/2/a (Misioni) të këtij Projekt Ligji thuhet:

2. Për të përmbushur misionin e tij, Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ushtron këto kompetenca:

- a) jep dhe heq licencën/certifikaten individuale të ushtrimit të profesionit;
- b) vendos standarde etike dhe deontologjike, të detyrueshme për cdo Inxhinierit Hidroteknik dhe monitoron zbatimin e tyre gjatë ushtrimit të profesionit;

Profesioni i Inxhinierit në përgjithësi, përfshirë këtu edhe inxhinierin Hidroteknik sipas Ligjit 8402 date 10.09.1998 dhe me vendimin Nr 943 dt 28.12.2016 i rishikuar është

tashmë i rregulluar nëpërmjet Licensimit të cilat administrohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Pra nëpërmjet këtij propozimi po kërkohet ti hiqet e drejta e Licensimit sektorit të Licensimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe ti kalojë në administrim Urdhërit të Inxhinierit Hidroteknik. Kjo justifikon edhe qëllimin kryesor të krijimit të këtij Urdhëri, pra monopolizimin e sektorit të licensave në dorë të një grupi individësh nën petkun e Urdhërit të Hidroteknikut.

4. Në Nenin 3/2/ç (Misioni) të Projekt Ligjit të UIH-t të propozuar thuhet se :
ç) rivlereson periodikisht kompetencën dhe performancën profesionale të anëtarit të Urdhrit përballe standardeve të vendosura;

Si do të bëhet ky rivlerësim dhe cili është qëllimi i këtij rivlerësimi është shumë i qartë, të krijojë skema “provimesh, certifikimesh etj” për të mbajtur nën kontroll Inxhinierin Hidroteknik në mënyrë të vazhdueshme.

Por nuk mbaron me kaq misioni i Urdhërit të Inxhinierit Hidroteknik pasi ky mision sipas pikës e) përfshin:

e) angazhimin në veprimtari shërbimi për vlerësimin dhe ekspertizën teknike drejtpërdrejt të institucioneve financiare dhe sigurorese, si institucion i vetëm në fushën e veprimtarisë hidroteknike;

Pra kuptojmë që Urdhëri i Hidroteknikut i jep të drejtën vetes si i vetmi institucion për vlerësimin dhe ekspertizën teknike në fushën Hidroteknike. Në këtë mënyrë ai përjashton çdo inxhinier Hidroteknik në vendin tonë të përfshihet në këto shërbime duke mos patur asnjë konkurent në këtë drejtim dhe duke qënë kështu në shkëlqe të ndalimeve të vendosura nga Neni 4/1 i Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS.

5. Në Nenin 4 (Përkufizime) të Projekt Ligjit të UIH-t të propozuar thuhet se :
5. "Çertifikatë" është dokumenti që vërteton të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën e veprimtarisë hidroteknike e leshuar nga Urdhri Profesional i Inxhinierit Hidroteknik dhe nënshkruar nga vetë poseduesi.

17. "Kolaudues" është vlerësuesi i dokumentacioneve, të cilësisë, të sigurisë dhe qëndrueshmërisë së veprimeve të arrira dhe certifikuesi përfundimtarë i regjistrimit të projektit për shfrytëzim apo përdorim.

Profesioni i Inxhinierit Hidroteknik sipas Ligjit 8402 date 10.09.1998 dhe me vendimin Nr 943 dt 28.12.2016 i rishikuar është tashmë i rregulluar nëpërmjet Licensimit të

cilat administrohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës përfshirë këtu edhe kategorinë e Kolauduesve.

18. "Komisioni Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional", është organ i gjykimit disiplinor profesional në shërbim të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik dhe funksionon si organ kolegjal vendimmarrës.

19. "Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional", është organ kolegjal vendimmarrës, i shqyrtimit të kërkesave për Ankimin të shërbimit hidroteknik, dhe funksionon si organizëm i gjykimit profesional pranë Urdhrit.

Nëpërmjet këtyre Komisioneve UIH-i do të ushtrojë kompetencat e tij kontrolluese dhe ndëshkuese mbi Profesionistët, gjë e cila i siguron atij një pushtet të pamërituar dhe diskriminues për profesionistët inxhinierë Hidroteknikë në vendin tonë.

20. "Komisioni i Provimit të Shtetit" është organ kolegjal vendimmarrës që funksionon si institucion i pavarur dhe ka një qëllim të përcaktuar si në këtë ligj.

Vëmë në dijeni se kjo bie ndesh me Ligjin Nr 10 171, Neni 4 pika e) në të cilin thuhet:

e) "Provimi i shtetit" është kontrolli vetëm për njohuritë profesionale të kandidatit, që organizohet në përputhje me legjislativën në fuqi. Ky provim kryhet sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë ligj dhe vlerëson njohuritë dhe aftësitë e kandidatit për ushtrimin e një profesioni të rregulluar.

1. Provimi i shtetit organizohet dhe zhvillohet nga ministria që mbulon fushën e arsimit, në bashkëpunim me autoritetin kompetent përkatës.

2. Me urdhër të ministrit që mbulon fushën e arsimit dhe të autoritetit kompetent përkatës ngrihet Komisioni i Provimit të Shtetit, me këtë përbërje:

Nuk e lejon Kushtetuta të bëhen ligje mbi ligje për të njëjtin qëllim dhe më pas të lexojmë faqen që na intereson sipas rastit dhe interesit të momentit.

Në këto kushte "Provimi i shtetit" do të bazohet në Nenin 4/20 të Projekt Ligjit të Urdhrit të Hidroteknikut apo në Ligjin Nr 10 171, Neni 4 pika e) ?

33. "Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik (QTPH)", është kolegji profesional i lartë, institucion i edukimi me orientim profesional, që përgatit profesionistë me aftësi praktike, në fushën e veprimtarisë hidroteknike dhe të pershtatshmërisë me të, për studentët me titullin Inxhinier Hidroteknik.

Sic kuptohet Urdhëri i Hidroteknikut do të themelojë një Universitet të dytë (Kolegj Profesional) i cili do të bëjë të mundur që studentët me titull Inxhinier Hidroteknik të quhen Profesionistë. Duket e pakuptimtë kur Universiteti Politeknik është i vetmi Institucion që të jep një Diplomë të vlefshme për vlersimin e aftësive profesionale në një fushë të caktuar. ?????

40. "Urdhëri i Inxhinierit Hidroteknik", është enti publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashketa të anëtarëve të Urdhrit profesionit në fushën e veprimtarisë hidroteknike dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.

Sic kuptohet "Urdhëri i Inxhinierit Hidroteknik", është i pavarur dhe mbahet me të ardhurat e veta, që siguron nga administrimi i Urdhërit.

41. "Urdhër Profesional Hidroteknik", është titull pune që i jepet anëtarit të Urdhrit pas trajnimit tekniko-profesional, i cili ka prezantuar punime kërkim-studimi dhe zbatimi, të cilat janë vlerësuar nga panele/borde inxhiniero-teknik te Urdhrit.

Pra një inxhinier Hidroteknik do të marrë Titullin e Urdhërit vetëm pasi ka kaluar trajnimet dhe ka justifikuar tek Urdheri aktivitetin e tij profesional duke krijuar kështu një varësi profesionale direkte nga Urdhëri.

6. Në Nenin 5 (Fushat e veprimtarisë hidroteknike) të Projekt Ligjit të UIH-t të propozuar thuhet se :

Ky ligj e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe zbatohet për të gjithë Inxhinierët Hidroteknik që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik dhe atë privat.

Pra është e qartë që cdo Inxhinier apo specialist që kërkon të ushtrojë aktivitetin e tij në vendin tonë do të jetë tërësisht i varur nga UIH-i në cdo ditë të jetës së tij profesionale. Në këtë kuadër Institucioni të cilit do ti nënshtrohen Inxhinierët Hidroteknikë është organizuar sipa këtij Projekt Ligji si më poshtë:

KREU II TE DREJTAT E URDHËRIT

Neni 8

Të drejtat e Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik

Në bazë dhe zbatim të këtij ligji Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik ushtron këto të drejta:

1. E drejta e vetëqeverisjes:

- a) nxjerr vendime, urdhra dhe udhëzime që janë të detyrueshme për veprimtarinë e inxhinierëve hidroteknik;
- b) miraton buletine, manuale, metoda dhe rregullore teknike të detyrueshme për zbatim në projekte zhvillimi dhe administrimi në fushën e veprimtarisë hidroteknike;
- c) krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, sipas ligjit organik;
- ç) krijon komisione të përhershme dhe të përkohshme sipas nevojave për veprimtarinë hidroteknike.

Pra nëpërmjet këtyre kompetencave Urdhëri i Hidroteknikut kthehet në një qeveri më vete e pavarur nga qeveria qendrore shtetërore, duke krijuar sektorë administrativë dhe ligjorë të cilat bëhen detyruese për çdo inxhinier hidroteknik që kërkon të ushtrojë profesionin në Republikën e Shqipërisë. Me fjalë të thjeshta Urdhëri i Hidroteknikut bëhet Shtet brenda Shtetit.

2. E drejta e edukimit të nivelit të lartë:

- a) zhvillon edukim të vazhdueshëm profesional gjatë karrierës dhe siguronë mundësi për zhvillim profesional për ata inxhinierë/specialist dhe nënspecialist që ka nën mbikëqyrje;
- b) vlerëson performancën e inxhinierëve dhe specialistëve që ka nën mbikëqyrje.

3. E drejta e çertifikimit/liçencimit profesional:

- a) ushtron të drejtën e çertifikimit/liçencimit të profesionistëve të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknike;
- b) ushtron të drejtën e vlerësimit, kategorizimit dhe pajisjes me dëshmi profesionale të specialistëve të nivelit jo inxhinier që punojnë në fushat e veprimtarisë së hidroteknikës;

4. E drejta e çertifikimit të shërbimeve:

- a) ushtron të drejtën e çertifikimit të të dhënave dhe matjeve brenda fushës së veprimtarisë hidroteknike;
- c) krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, sipas ligjit organik;
- ç) krijon komisione të përhershme dhe të përkohshme sipas nevojave për veprimtarinë hidroteknike.

I gjithë ky seksion i jep mundësinë Urdhërit të Hidroteknikut të mbajë nën kontroll çdo individ dhe profesionist nga niveli Inxhinierik deri në atë të specialistit të mesëm apo teknik profesional që nga momneti që mbaron studimet e profesionale deri sa të dalë në pension, duke i dhënë apo hequr të drejtën e ushtrimit të profesionit. Sic e kemi përmendur më sipër profesoioni i Inxhinierit është një profesion i rregulluar dhe Licensuar nga organet kompetente sipas Ligjit 8402 date 10.09.1998 dhe me

vendimin Nr 943 dt 28.12.2016 i rishikuar, dhe nuk ka arsye për t'ja u hequr këtë të drejtë institucioneve shtetërore dhe për ti dhurua tek një grup individësh të cilët do të vetëqeverisen sipas nenit 8 ketij propozimi.

Në vazhdim të të drejtave që urdhëri propozon për veten e tij kemi :

2. E drejta e edukimit të nivelit të lartë:

a) zhvillon edukim të vazhdueshëm profesional gjatë karrieres dhe siguron mundësi për zhvillim profesional për ata inxhinierë/specialist dhe nënspecialist që ka nën mbikëqyrje;

b) vlerëson performancën e inxhinierëve dhe specialistëve që ka nën mbikëqyrje.

3. E drejta e çertifikimit/liçencimit profesional:

a) ushtron të drejtën e çertifikimit/liçencimit të profesionistëve të nivelit të lartë të inxhinierëve hidroteknike;

b) ushtron të drejtën e vlerësimit, kategorizimit dhe pajisjes me dëshmi profesionale të specialistëve të nivelit jo inxhinier që punojnë në fushat e veprimtarisë së hidroteknikës;

Pra Urdhëri i Hidroteknikut i jep vetes të drejtën e vlerësimit të njohurive duke vënë në dyshim formimin profesional Universitar si dhe merr përsipër çertifikimin/liçencimin profesional gje e cila bie ndesh me ligjet aktuale siç kemi theksuar më sipër.

6. E drejta e pronësisë:

a) ushtron të drejtën e pronësisë që e fiton, shet dhe jep në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tij, si dhe ushtron të drejta të tjera sipas menyrës së përcaktuar me ligj;

b) e drejta e pronësisë ushtrohet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

7. E drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike:

a) ushtron të drejtën e veprimtarisë ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit, nëpërmjet krijimit të njësive ekonomike e institucione nëvarësi të tij;

b) ushtron të drejtën e përdorimit të të ardhurave që përfitohen nga veprimtaria ekonomike për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.

8. E drejta e personit juridik, gëzon dhe ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjisllacionit në fuqi:

a) të drejtën e lidhjes së kontratës;

- b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridike;
- c) të drejtën e ngritjes së padisë civile dhe penale;
- 9) të drejtën e mbajtjes së llogarive;
- d) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve

Në vazhdim të autonomisë dhe pavarësisë që Urdhëri i Hidroteknikut i jep vetes ai do të gëzojë të drejtën e menaxhimit financiar dhe kapitaleve të pronësisë duke i konsideruar këto asete që nuk kontrollohen dhe menaxhohen nga shteti por që do të jenë në pronësi të Urdhërit gjë e cila bie ndesh me Ligjin Nr.8788, datë 7.5.2001 PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE. Ky është një urdhër që jo vetëm është fitimprurës, por ka pushtet të pakontrolluar mbi të ardhurat e tij, si të ishte një kompani private që nuk jep lloagri askund, mjafton te paguaje Taksat dhe detyrimet, për të cilat në këtë ligj nuk flitet fare.

KREUIV

ANETARI I URDHËRIT

Neni 12

Kriteret e anëtarësisë në Urdhër

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e Inxhinierit Hidroteknik, si edhe të punojë në fushën e veprimtarisë hidroteknike në institucionet/sectorin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhërit, si edhe pa qenë i pajisur me Liçencen/Çerifikatë për atë shërbim të lëshuar nga ky organizëm.

ç) të njohin dhe të deklarohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e këtij ligji, Kodin e Etikeës dhe Deontologjisë, si edhe ligjet në fuqi.

3. Çdo Inxhinieri Hidroteknik, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri, apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë, duhet të anëtarësohet paraprakisht në Urdhërin Inxhinierit Hidroteknik të Republikeës së Shqipërisë, si edhe duhet të ketë keto dokumente:

a) lejen e qendrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë; etj

Pra kuptohet mjaft qartë qëllimi dhe arsyeja se pse është propozuar krijimi i Urdhërit të Hidroteknikut i cili është i destinuar vetëm për të krijuar monopol dhe për të përqëndruar në duar të një grupi njerëzish të drejtën e ushtrimit të profesionit të hidroteknikut në Republikën e Shqipërisë. Ne jemi një profesion i rregulluar dhe në përshtatje me të gjitha kërkesat dhe standartet që kërkohen sipas Ligjit 8402 datë 10.09.1998 dhe me vendimin Nr 943 dt 28.12.2016 i rishikuar është tashmë i

rregulluar nëpërmjet Licensimit të cilat administrohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Urdhëri ka menduar edhe për të ardhurat e tij të cilat sipas këtij projekt ligji i siguron nëpërmjet :

4. Anëtarët e Urdhrit kanë detyrim të paguajnë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e rregjistrimit, të liçencimit/çertifikimit dhe për shërbime të tjera administrative, sipas përcaktimit në këtë ligj dhe statutin e urdhrit.

5. Individëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilët e kanë të dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional për ushtrimin e këtij profesioni, sipas shkronjes "b", të pikës 2, të këtij neni, u lind e drejta e menjëhershme e anëtarësisimit në Urdhër.

Neni 13

Të drejtat e anëtarit të Urdhrit

Anëtari i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik ka të drejtë:

1. Të ushtrojë profesionin në profilin e liçencuar/çertifikuar.

2. Të ankohet në organet e Urdhrit kur i shkelen të drejtat dhe mundësitë për ushtrim autonom, të lirë dhe të pavarur të profesionit.

Është e qartë që Urdhëri i jep të drejtën vetes të menaxhimit të profesionit të Hidroteknikut në cdo aspekt të tij, që nga e drejta e ushtrimit të profesionit nëpërmjet licensimit deri tek e drejta për tu ankuar apo shpjeguar para Urdhërit për cdo aktivitet të tij profesional duke krijuar varësi totale nga Urdhëri.

Neni 14

Ndërprerja e anëtarësisimit

1. Anëtarit të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik i ndërpritet anëtarësia në këto raste:

a) kur vdes;

b) kur i hiqet liçenca/çertifikata individuale e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor të formës së prerë nga organet e Urdhrit apo të Gjykatës;

c) kur është duke vuajtur dënimin penal me heqje lirie;

9) kur nuk paguan kuotizacionet në përputhje me afatet e vendosura në këtë ligj dhe statut.

Pra kuptohet qartë që Urdhëri në këtë rast e konsideron veten të barabartë me Gjykatën e cila ka të drejtë të të heqë Licensën në raste të caktuara. Ky është një

pushtet i rrezikshëm në duart e Urdhërit që nuk duhet përkrahur dhe jo më aprovuar me Ligj për tu bërë më ps detyruës per cdo Inxhinier Hidroteknik në veëndin tonë.

Neni 15

Detyrimet e anëtarëve të Urdhrit

Anëtari i Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik ka këto detyrime:

b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësise në veprimtarinë hidroteknike, si edhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit të vazhdueshëm profesional;

c) të paguajë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifat e regjistrimit, të dhënies së të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe shërbime të tjera administrative, në përputhje me këtë ligj, statutin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Anëtarët e urdhërit janë të detyruar ti përgjigjen kërkesave për pagesat e vendosura nga Urdhëri pasi në të kundërt humbasin të drejtën e ushtrimit të profesionit.

Neni 17

Asambleja Kombetare

b) zgjedh Presidentin e Urdhrit me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 7-vjeçar;

Neni 18

Këshilli Kombëtar

c) zgjedh Zëvendës Presidentin e Urdhrit me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 7-vjeçar;

c;) zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm të Urdhrit; me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj për një mandat 7-vjeçar;

3. Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit janë njëkohësisht edhe Drejtuesit e Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik.

4. Zgjedhjet për Këshillin Kombëtar bëhen çdo 7 vjet, në hazë të rregullave të përcaktuara në statutin e Urdhrit.

Është gjykuar e mjaftueshme kohëzgjatja prej 7 vjetësh e Presidentit të Urdhërit për të përmbushur qëllimet e tij drejtuese si dhe nuk ka kufizim në rast se Presidenti do të rikandidojë për të vazhduar punën e nisur. Pra në cdo rast ky është një institucion i cili nuk çlirohet dot kollaj nga nomenklatura që e ka krijuar atë, pasi edhe Zëvendës

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu kanë një mandat 7 vjecar dhe pa kufizim rizgjedhje. Ata janë njëkohësisht edhe Drejtuesit e Asamblesë dhe Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik. Është një strukturë e cila pushton jo vetëm urdhërin por bëhet precedent për të gjithë institucionet e tjera të ngjashme ose jo që mund të krijohen në të ardhmen, jo vetëm në sektorin inxhinierik por në cdo fushë të jetës profesionale në vendin tonë.

Janë po këta individë të cilët janë edhe pjesë e Kryesisë së Urdhërit sipas:

Neni 20

Kryesia e Urdhrit

1. Kryesia është organ ekzekutiv i Urdhrit.
2. Kryesia përbëhet nga:
 - a) Presidenti i Urdhrit;
 - b) Zëvendës Presidenti i Urdhrit,
 - c) Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit;
 - 9) Kryetari i Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional;
 - d) Drejtori i Qendrës të Trajnimit Profesional Hidroteknik.

Dhe aktiviteti i tyre është i përcaktuar qartë dhe saktë në këto kompetenca:

6. Kryesia e Urdhrit ushtron edhe këto kompetenca:
 - a) thërret Këshillin Kombëtar të Urdhrit;
 - b) përgatit rregulloren për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme;
 - c) përgatit Statutin dhe rregulloret e Urdhërit;
 - 9) përgatit Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Inxhinierisë Hidroteknike;
 - d) përgatit projektvendimin për miratim e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional;
 - dh) përgatit rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit;
 - e) përgatit rregulloren e praktikës profesionale;
 - e) përgatit rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhërit;
 - f) përgatit projektvendimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit, si edhe vlerësimin e krediteve;
 - g) përgatit projekt programin dhe projekt buxhetin e Urdhrit;
 - gj) përgatit raportin vjetor të Urdhrit;
 - h) përgatit programet e trajnimit profesional hidroteknik;
 - i) përgatit mbledhjet e Asamblesë.

Pra është shumë e qartë që qëllimi i këtij Projekt Ligji është vetëm monopolizimi i licensimit të profesionistëve hidroteknikë të cdo niveli, për pasojë edhe i tregut në përgjithësi, pasi që këtu fillon menaxhimi i këtij sektori të rëndësishëm të

veprimtarisë hidroteknike. Kryesia e Urdhërit vishet me pushtet të garantuar nëpërmjet këtij Ligji dhe asnjë kontroll nuk mund të ushtrohet mbi të. Për më tepër kjo kryesi ka edhe Gurin edhe Arrën në dorë pasi i përgatit vetë të gjithë rregulloret dhe vendimet mbi bazë të të cilave ushtron aktivitetin Urdhëri i Hidroteknikut. Nuk ka inxhinier në Shqipëri që e pranon dhe e toleron këtë, duke i vënë në pjetë të artë Urdhërit ose më saktë Kryesisë së Urdhërit të Hidroteknikut të gjithë jetën profesionale të cdo specialisti dhe cdo kategorie në fushën Hidroteknike në vend. Është e papranueshme dhe e pajustificueshme as profesionalisht dhe as juridikisht që kjo iniciativë të gjejë mbështetje nga asnjë deputet, inxhinier ose jo, i majtë apo i djathtë, pasi kjo shkel parimet themelore të lirisë së ushtrimit të profesioit të hidroteknikut në vendin tonë. Do bëhemi vendi i parë në botë që implementon të tilla skema menaxhimi profesioni të cilat në të ardhmen bëhen të pakontrolluara dhe të pa menaxhuara as nga shteti as nga profesionistët, duke konsideruar këtu edhe listën e gjatë të profesioneve të ngjashme inxhinierike që dalin nga Universitetet Politeknike, liste e cila ndryshon nga viti në vit, shtimin e specialiteteve inxhinierike për shkak të avancimit të teknologjisë dhe nevojave për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës.

Neni 23 Financimi

1. Urdhëri i Inxhinierit Hidroteknik është ent publik jobuxhetor, ai ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe e administron Këshilli Kombëtar në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky Këshill.
2. Burimet financiare të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik janë të ardhurat nga:
 - a) kuotizacionet e anëtarësisë, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Urdhrit;
 - b) tarifat e regjistrimit;
 - c) tarifat e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;
 - 9) tarifat e shërbimit;
 - d) grande, donacione tëndryshme vendase dhe të huaja të ligjshme;
 - dh) aplikimet, projektet, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
3. Teë ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në piken 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me këtë ligj.

Pra aktiviteti ekonomik i Urdhërit të Hidroteknikut është i gjithi i pavaruar, i pakrollueshëm, dhe nën administrimin e Kryesisë së tij. Urdhëri gjen forma dhe mjete nga më të ndryshmet për të siguruar të ardhura, duke filluar nga kuotat e anëtarësisë, dhurata dhe donacione deri tek projekte të zhvilluara nga Urdhëri. Për

cfarë projektesh bëhet fjalë këtu, pasi janë profesionistët dhe kompanitë përkatëse që marrin pjesë në projekte, dhe nuk besoj se bëhen tendera dhe gara ndërmjet Urdhërave? Në këto kushte urdhëri konkurron me anëtarët e tij. Skemë kjo e ngjashme me propozimin e Urdhërit të Inxhinierit cuditërisht.

KREU VII

E DREJTA, PRAKTIKA PROFESIONALE, PROVIMI I SHTETIT

Neni 24

E drejta e ushtrimit te profesionit

1. Profesionit i Inxhinierit Hidroteknik ushtrohet, me cilësinë e të vetëpunësuarit ose të të punësuarit, në sektorët publik të institucioneve qendrore dhe vendore, në sektorin akademik apo mësimdhënie, sipas kërkesave dhe parimeve të përcaktuara nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.
2. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të Inxhinierit Hidroteknik e ka cdo person, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj si me posht:
 - a) të ketë kryer ciklin tre plus dy të studimeve në nivel master profesional, apo ciklin e plotë në kursin e Inxhinierisë Hidroteknike;
 - b) të kryejë praktikën profesionale;
 - c) të ketë dhënë provimin e shtetit;
 - 9) të ketë dokument zyrtar diplomën me titullin inxhinier hidroteknik;
 - d) të regjistrohet në Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik
3. Nuk mund të ushtroje profesionin në veprimtarinë hidroteknike pa u regjistruar më parë në Urdhër, si edhe pa u pajisur me dokumentin e identifikimit (ID).
4. Ushtrimi i veprimtarisë hidroteknike në sektorin publik, privat, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, lejohet vetëm për Inxhinieret Hidroteknik të cilët plotësojnë kushtet e këtij ligji.
5. Juridiksioni i anëtarëve të Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, individual dhe të personave juridike, ushtrojnë shërbimin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
6. Cdo shtetas i huaj, për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë, u nënshtrohet kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe dispozitave që parashikohen në këtë ligj.

Pra në fund të gjithë ujrën mbushin basenin e Urdhërit Hidroteknik. Edhe shteti do kërkojë profesionistë tek UIH dhe vetëm me lejen e tij cdo individ mund të gëzojë të drejtën që i ka dhënë arsimimi apo kualifiket e pafund që mund të bëjë gjatë karrierës së tyre, vetëm nëse kanë marrë “Bekimin e UIH”.

Është e frikshme si mund të ngrsh kartonin për të aprovuar një Ligj të tillë, i cili as në rendet diktatoriale nuk shpreheshin kaq hapur dhe me këtë lloj brutaliteti. Liria profesionale për Profesionistin Hidroteknik të cdo kategorie kalon vetëm nëpërmjet UIH.

Dhe nuk ka të ndaluar pushteti i UIH:

Neni 25

Praktika profesionale

1. Perpara kryerjes se provimit te shtetit kandidati per titullin Inxhinier Hidroteknik duhet te kryeje praktiken profesionale.
2. Praktike profesionale eshte ushtrimi i profesionit per nje periudhe jo me pake se 1 vit nga ana e kandidatit, sipas sistemit dual nen drejtimin e pergjegjesine e nje profesionisti hidroteknik te kualifikuar. Kandidati gjate kohes se praktikes do te mund te pajiset me nje formim shtese, sipas menyres se percaktuar ne statusin e Urdhrit dhe legjislacionit ne fuqi.
3. Ne rast se kandidati nuk zbaton programin e praktikes profesionale ne kohen dhe detyrimet e percaktuara ne statutin e Urdhrit, periudha kohore e praktikes me kerkese te tij perseritet edhe per nje vit tjeter, ne rast te kalimit te afatit te percaktuar me siper, atehere kandidati nuk kualifikohet, ne kete rast Kryesia e Urdhrit i propozon Keshillit Kombetar, per marje vendimi te arsyetuar.
6. Ne perfundim te praktikes profesionale, kandidati i nenshtrohet "Vleresimit per aftesimin praktik". Praktika profesionale konsiderohet e kryer vetem pas vleresimit pozitiv te aftesimit.
7. Modalitetet e organizimit te vleresimit te aftesimit praktik percaktohen ne rregulloren e praktikes profesionale, qe miratohet me vendim te Keshillit te Kombetar te Urdhrit te Inxhinierit Hidroteknik.

Pra ky është një tjetër filtër nga i cili duhet të kalosh në rrugën e gjatë të formimit tënd profesional, dhe sic kuptohet të gjithë rrugët të cojnë tek UIH. Është UIH që vendos nëse kalon apo jo për fazen tjetër aë të provimit të shtetit i cili gjithashtu mban ne rrjetën e tij një numër të caktuar profesionistësh. Provimi i Shtetit organizohet nga Ministrinë e linjës si ajo e Arsimit dhe Energjetikës, nga Universiteti si dhe nga Urdhëri UIH. Deri këtu në rregull duket struktura organizative por po të lexosh deri në fund të këtij neni 27 pika 11 thotë:

Neni 27

Organizimi i Provimit te Shtetit

1. Provimi i Shtetit organizohet nga ministria qe administrosh fushen e edukimit, nga ministria qe administrosh <eshtjen e punesimit, nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik, si edhe nga Fakulteti/Departamenti i Inxhinierise Hidroteknike.

11. Urdhri përcakton, kohën e punës, shpërblimin e anëtareve të Komisionit të Provimit të Shtetit, dokumentin zyrtar, shpenzimet administrative dhe metodologjinë e përlogaritjes së tarifës së shërbimit.

Pra e gjithë struktura në fund fare varet tërësisht nga Urdhëri inxhinierit Hidroteknik. Me këtë urdhëri ka në dorë gjithcka i duhet për të uzurpuar dhe manipuluar procesin e provimit të shtetit, i cili nuk ka arsye të zhvillohet duke qenë se me përfundimin e studimeve në Universitet studentet marrin një dokument i cili vërteton që kanë përfunduar ciklin e plotë të studimeve në nivel Bachelor apo Master për Inxhinieri Hidroteknike. Këtu Lufta bëhet thjesht për pushtet.

Dhe në fakt ka disa mënyra për të kontrolluar dhe për të monopolizuar profesionin e Inxhinierit Hidroteknik nëpërmjet UIH. I gjithë Kreu VIII / PAPAJTUSHMERIA, PERSON! FIZIK/JURIDIK, FUNKSIONI PUBLIK

Në këtë kapitull është përcaktuar qartë që gjithcka varet nga UIH.

Neni 29

Perfaqesimi i personave fizike/juridike

1. Shërbimi i Inxhinierisë Hidroteknike ushtrohet nga persona fizike/juridike, të certifikuar/licensuar sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Vetëm inxhinierët të certifikuar/licensuar mund të jenë ortakë, aksionere dhe administratorë të një shoqërie që ushtrojnë shërbimet e inxhinierisë hidroteknike.

5. Cdo Shoqëri Private, Agjenci Shtetërore, Universitet (fakultetet/departamentet), duhet të regjistrohen dhe të certifikohen/licensohen në Urdhërin e Inxhinierit Hidroteknik, sic parashikohet në këtë ligj. Agjencitë shtetërore dhe universitetet, duhet të regjistrohen dhe të certifikohen/licensohen në Urdhër, nëse kanë si politikë të tyre ushtrimin e profesionit, në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës.

Neni 31

Dokumentin e identifikimit (ID)

1. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik do të pajisë të gjithë inxhinieret hidroteknik me dokumentin e identifikimit (ID), si dhe kandidatin për marrjen e titullit që në kohën e

regjistrimit ne praktiken profesionale.

2. Cdo inxhinier eshte i detyruar te pajiset me ID-ne, i cili eshte dokumenti zyrtar identifikues per perdorimin e titullit inxhinier hidroteknik. Ky dokument eshte vjetor dhe

prodhohet nga Urdhri nje here ne vit brenda periudhes dy mujore Jarrar- Shkurt.

3. Cdo inxhinier hidroteknik pajiset me ID-ne, pasi te kete paguar kuotizacionin vjetor.

4. Ne rast se nje inxhinier hidroteknik nuk pajiset me ID-ne vjetore, nuk mund te ushtroje profesionin dhe aktiviteti i tij konsiderohet i pezulluar, automatikisht edhe perfaqesimi i personave fizike/juridik ku ushtron profesionin konsiderohet i pezulluar.

5. Dokumenti i identifikimit (ID) i anetarit te Urdhrit, duhet te permbaje te dhena qe i perkasin aftesise teknike, kualifikime dhe kreditet (ECTS), si edhe te dhena qe i perkasin atij ne lidhje me perfaqesimin te parashikuara ne kete ligj dhe akte nenligjore ne zbatim te ketij ligji.

Pra në cdo nen vetëm përcaktohen kritere pafund të cilët cimentojnë pushtetin e Urdherit ne ushtrimin e profesionit te Inxhinierit Hidroteknik dhe asgje tjetër. Qëllimi është vetëm një dhe i qartë, të japin në administrim te UIH gjithë kapacitetin intelektual dhe aktivitein profesional qe rrjedh nga ushtrimi i profesionit te Inxhinierit Hidroteknik ne vendin tonë.

Në këtë pushtet është përfshirë cdo individ apo subjekt pa perjashtuar këtu as Universitetet që ushtrojnë veprimtari ne fushën inxhinierike Hidroteknike.

Kjo duket qartë tek :

Neni 34

Detyrimi per regjistrim

1. Detyrohen të regjistrohen në Regjistrin e Urdhrit:

a) Inxhinierët Hidroteknike si individë;

b) Shogërite tregtare të formës person juridik, me kapital privat dhe shtetëror të cilat detyrohen të regjistrohen paraprakisht prane QKB-it;

c) Agjencitë Shtatëre që kanë objekt dhe inxhinier që e ushtrojnë profesionin në fushat e veprimtarise Hidroteknike;

ç) Universitetet (departamentet) që ushtrojne profesionin në fushat e veprimtarisë Hidroteknike.

KREUX

EMERTIMI I ÇERTIFIKATAVE/LIÇENCAVE

Neni 35

Emertimi i çertifikatave/Liçencave

1. çdo person fizik/juridik, është i detyruar të kryejë shërbime, vetëm pasi të jetë pajisur me certifikatën/liçencën, për të drejtën e ushtrimit të profesionit, si edhe llojit të shërbimit.
5. cdo subjekt fizik/juridik privat që ushtron aktivitetin me certifikatën/liçencën "Studim dhe Monitorim", "Projektim", "Mbikëqyrje dhe Kolaudim", "Vlerësim dhe Ekspertizë Teknike", nuk mund të pajiset me certifikatë/liçencë në "Menaxhim Projekt".
6. cdo subjekt juridik shtetëror që kanë objekt dhe ushtrime nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik profesionin në fushat e veprimtarisë hidroteknike, mund të pajisen vetëm me certifikatën/liçencën "Projektim" dhe me "Menaxhim Projekt".
7. Agjencitë shtetërore që kanë objekt administrimi dhe monitorimi dhe që kryejnë shërbim nëpërmjet inxhinierëve hidroteknik në fushat e veprimtarisë hidroteknike, mund të pajisen vetëm me certifikatë/liçencë "Vlerësim dhe Ekspertizë Teknike".
8. Universitetet (Fakultetet/Departamentet) që ushtrime profesionin në fushat e veprimtarisë hidroteknike mund të pajisen vetëm me certifikatë/liçencë "Studimi dhe Monitorimi".

Pra i gjithë qëllimi është kapja e certifikimit/licensimit të inxhinierit nga Urdhëri i Inxhinierit Hidroteknik.

Ndërkohe që aktualisht ky Licensim bëhet nga Ministria e Energjetikës dhe Infrastruktura njësoj si për të gjitha specialitetet e tjera inxhinierike. Pra nuk ka arsye se pse të hiqet ky Licensim nga organet Shetërore dhe të kalojë në administrim një Enti të Pavarur, pasi profesioni i Inxhinierit në fakt për vetë rëndësinë që ka duhet të kontrollohet nga shteti gjatë gjithë veprimtarisë së saj.

Jo vetëm strukturat inxhinierike, universitetet, shoqëritë apo studiot e ndryshme por edhe ato teknike profesionale në fushën hidroteknike do të varen nga Urdhri i Hidroteknikut.

KREUXIV DESHMI PROFESIONALE

Neni 46 **Specialistët plotësues**

1. Individet që punojnë në fushën e veprimtarisë së hidroteknikës mund të kualifikohen dhe kategorizohen për aftësitë e fituara gjatë punës së tyre në nivele vlerësimi për të cilët pajisen me deshmi profesionale nga Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik.
9. Urdhri i Inxhinierit Hidroteknik përcakton emërtimin dhe detyrat për secilin nga specialistët dhe nën specialistët plotësues dhe kualifikimin minimal.
10. Akti i vlerësimit të specialistëve dhe nën specialistëve përbejnë titull ekzekutiv.

Pra cdo aktivitet ne fushen Hidroteknike do te jenë nën mbikqyrjen dhe rregulloren e Urdherit e cila përgatit nga Kryesia e Urdhërit. Duket paradoksale te lesh ne duart e nje grupi individësh të drejën për të dhënë të drejtën apo për të hequr të drejtën e ushtrimit të nje profesioni me rregullore të përgatitura nga ata vetë pa një kontroll nga organet shtetërore, universitetet apo grupet e interesit si pjesë e rendesishme e procesit te ushtrimit te një profesioni sic eshte Hidrotekniku i cili duhet theksuar që ka të bëjë edhe strategjine kombetare të menaxhimit të burimeve ujore që përbëjnë burimin kryesor për prodhimin e energjisë elektrike në vend sot.

KREUXV
EDUKIMI PROFESIONAL
Neni 47

Qendra e Trajnimit Profesional Hidroteknik (QTPH)

I gjithë ky kapitull flet për strukturat e Trajnimit Profesional të detyrueshme sipas këtij Ligji për tu ndjekur nga te gjithë profesionistet Hidroteknik në vendin tonë. Paralelisht me shkollat profsionale që kemi sot në vend, paralelisht me kurset profesionale, paralelisht me Universitet Politeknike shteterore dhe private që kemi aktualisht UIH do të ndërtoje strukturat e veta nëpër të cilat do të jenë të detyruar të kalojnë herë pas here specialistët, inxhinierët hidroteknike mjeshtrit, etj për të marrë dhe për të vazhduar të mbajnë të drejën e ushtrimit te profesionit. Detyrimi për pjesëmarrje në këto qendra trajnimi përcaktohet me këtë ligj si formë kontrolli dhe presioni mbi profesionistet duke siguruar kështu në mënyrë të vazhdueshme të vjelin të ardhura nga profesionistet të cilët duhet te paguajnë tarifa te ndryshme pjesëmarrje, në këto QTPH për tësigurura kresitet e mjaftueshme që i lejojnë ushtrimin e profesionit të Hidroteknikut.

Gjithashtu është parashikuar në këtë Projektligj edhe një kapitull për dispozitat kalimtare nëpër të cilin do të kalojnë të gjithë profesionistet Hidroteknikë që është jo vetëm diskriminues por vë në dyshim edhe profesionalizmin dhe legjilacionin mbi të cili ky profesion ka ushtruar aktivitein e tij deri në aprovimin e këtij propozimi.

Neni 72

Dispozita kalimtare per individet qe ushtrojne profesionin e inxhinierit hidroteknik ne veprimtarine hidroteknike

1. Individet qe, ne momentin e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, ushtrojne ose kane ushtruar

profesionin e inxhinierit hidroteknik dhe kane te dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional per ushtrimin e ketij profesioni, sipas nenit 12, pikat 2 dhe 3, te ketij ligji, u lind e drejta e menjehershme e anetaresimit ne Urdher.

Pra ata do të vazhdojnë ushtrimin e aktivitetit të tyre profesional vetëm me rregjistrimin në këtë urdhër.

2. Personat fizik/juridik qe, ne momentin e hyrjes ne fuqi te ketij ligji, ushtrojne ose kane ushtruar profesionin e inxhinierit hidroteknik ne fushen e veprimtarise hidroteknike, mund te vazhdojne ushtrimin e profesionit te hidroteknikut per nje afat te caktuar nga Urdhri, por jane te detyruar te ndjekin programe te formimit dhe kualifikimit/rikualifikimit profesional, te pershtatshme per ushtrimin e profesionit te tyre brenda periudhes 2 vjecare.

Pra profesionistet aktuale hidroteknike do te rregjistrohen menjehere tek UIH por nuk do të shpëtojnë dot nga kontrolli i kualifikimit profesional që do të bëjë urdhëri për çdo anëtar të tij.

Në këtë kuadër një profesionis hidroteknik me një eksperience 30 vjecare, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Ligji do të duhet të rregjistrohet tek urdhëri dhe të shkojnë në shkollat e urdhërit brenda dy vitesh ????

3. Per ata individ, sipas dispozitave të këtij ligji, të kryejne provimin e shtetit, brenda nje periudhe vijuese 3 vite, nga hyrja ne fuqi e ketij ligji.

Dhe natyrisht që janë kujdesur që të mos i shpëtojnë detyrimit të Provimit të shtetit të gjithë profesionistët Hidroteknikë, për tu siguruar përfundimisht që Lista e Profesionistëve aktiv ne Republikën e Shqipërisë të jetë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e vendosura nga UIH.

1. Analiza tekniko-profesionale e shprehur nga mendimet e profesionistëve.

Ky është një proces shumë i rëndësishëm dhe delikat dhe iniciativa të tilla mund të rezultojnë drastike për jetën profesionale të kësaj shtrese të shoqërisë, ndaj shqyrtimi i tyre kërkon maturi, konsensus të gjërë dhe profesionalizëm të niveleve të larta.

Në këtë Projekt Ligj nuk e gjen veten të lirë dhe të motivuar asnjë nga Profesionistët që ushtrojnë aktivitetin e tyre ndër vite dhe aq më pak ata që do ti bashkohen këtij kontigjenti në të ardhmen. Cilido qoftë qëllimi i projektligjit, duhet të garantohet integriteti i gjithësecilit, e drejta për ushtrimin e profesionit, të shmangët abuzimi me

rryshfete për të kaluar klasën dhe për më tepër monopolizimi, dhënia me qera e liçensave (ndodh edhe me licensën e eficensës së energjisë psh), pazaret për certifikimin, përjashtimet nga e drejta e zhvillimit të profesionit, nga tenderat, presionet mbi profesionistët, dhe minimalisht heqjen e mundësisë për inxhinierët e rinj. Gjithsesi, profilizimi apo specializimi i secilit është fakt, dhe duhet të garantohet nëpërmjet instrumentave përkatës, totalisht përtej këtyre drafteve tipike të kamufluara nën fasadën e progresit apo standartizimit. Duhet garantuar e drejta e certifikimit akademik për ata që kanë dëshirë të fokusohen në studime të thelluara, por edhe liria e zgjedhjes dhe profilizimit të inxhinierit të materialeve, të cilësisë, të analistit të riskut, të inxhinierit të sigurisë, apo edhe e projektuesit që zhvillon projekte në përputhje me kërkesat e kohës sot por që janë të vlefshme edhe në të ardhmen, duke konsideruar edhe ndryshimet teknologjike që po zhvillohen çdo ditë.

Nisur nga të gjithë argumentet e mësipërme si dhe duke mos u ndjerë të përfaqësuar në këtë ligj ne nuk jemi dakort për aprovimin e tij dhe e kundërshtojmë atë më forcë pasi do të prishë balancat në treg, do të krijojë situata favorizuese për disa individë dhe diskriminuese për të tjerët si dhe do të krijojë një klimë profesionale të pabazuar në meritën profesionale të individit por të justifikuar nën petkun e aprovimit të urdhërit të inxhinierit Hidroteknik do të përjashtonte rregullimin e tregut sipas kërkesave të tij.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, jemi të gatshëm për çdo diskutim apo sugjerim në këtë proces.

Ky material do të dërgohet edhe në kopje fizike nëpërmjet postës.

Me respekt

SHOQATA UNIONI I INXHINIEREVE SHQIPTARE

Drejtoreshë ekzekutive ing Deshira Mena